Vendim nr. 286, datë 14.09.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 14.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 46 (A) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ANI HOXHOLLI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 50 (87-2023-216), datë 22.11.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1833, datë 02.12.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në pjesën që i përket kërkuesit, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 17, 27, 29, pika 3, 30, 31, 32, pika 2, 35, 42, pika 2 dhe 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pikat 1, 2 dhe 3, shkronjat "b" e "c" dhe nenet 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 71/a, 71/b dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ani Hoxholli ka ushtruar detyrën e punonjësit të Policisë Kufitare në pikën e kalimit kufitar Morinë, Kukës. Ai është proceduar penalisht nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) nën dyshimin se, në bashkëpunim me punonjës të tjerë të Policisë Kufitare, ka qenë pjesë e një skeme të vazhdueshme korruptive, që konsistonte në kërkimin dhe marrjen e shumave të parave nga shtetas të ndryshëm në këmbim të lehtësimit të kalimit kufitar. Sipas organit të akuzës, shumat e përfituara varionin nga 5 euro deri në 400 euro për rast, ndërsa veprimtaria organizohej në nivel turni, ku përgjegjësi përzgjidhte punonjësit, koordinonte funksionimin e skemës dhe, në përfundim të shërbimit, ngarkonte një kontrollor për mbledhjen e shumave të përfituara. Gjithashtu, sipas prokurorisë, disa prej të pandehurve, përfshirë kërkuesin, nën ndikimin e eprorëve dhe në kundërshtim me ligjin, kanë shmangur regjistrimin në sistemin TIMS të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve të ndryshëm nga Republika e Shqipërisë.

2. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria e Posaçme e ka akuzuar kërkuesin për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 259, paragrafi i parë, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal (*KP*). Në vijim, prokuroria ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, e cila është pranuar nga gjyqtari i seancës paraprake me vendimin e datës 02.12.2022.

3. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) ka pranuar kërkesën e kërkuesit për gjykim të shkurtuar. Me vendimin nr. 15, datë 21.02.2023, ajo gjykatë e ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale "Korrupsioni pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike", në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 259, paragrafi i parë dhe 25 të KP-së dhe, pas uljes së dënimit me një të tretën, në zbatim të nenit 406, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), e ka dënuar me 1 vit e 4 muaj burgim. Në zbatim të nenit 59 të KP-së, gjykata ka pezulluar ekzekutimin e pjesës së pavuajtur të dënimit me burgim, duke e vënë kërkuesin në provë për një periudhë prej 2 vjetësh e 8 muajsh, si dhe i ka hequr të drejtën për të ushtruar funksione publike për një periudhë 5-vjeçare. Sipas asaj gjykate, nga vlerësimi në tërësi dhe në unitet me njëra-tjetrën i provave të administruara është provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi ka konsumuar elementet e veprës penale për të cilën

akuzohet, pasi gjatë ushtrimit të detyrës, në bashkëpunim me disa nga të pandehurit e tjerë, kolegë të tij, ka marrë pjesë në veprimtarinë korruptive të kërkimit dhe marrjes së shumave të parave nga shtetasit që kalonin në atë pikë kufitare. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim dhe, në vijim, edhe një shtesë ankimi.

4. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 50 (87-2023-216), datë 22.11.2023, ka ndryshuar vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale dhe masën e dënimit për kërkuesin, duke e deklaruar atë fajtor për kryerjen e veprës penale "Moskallëzimi i krimit", të parashikuar nga neni 300, pika 1, i KP-së dhe, në zbatim të nenit 406, pika 1, të KPP-së, e ka dënuar me 10 muaj burgim. Gjykata e apelit ka ndryshuar edhe dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike, duke e caktuar atë për një periudhë 2-vjeçare. Sipas gjykatës së apelit, nga analiza e provave të administruara nuk rezultonte që kërkuesi të kishte kryer veprime konkrete të kërkimit, marrjes ose pranimit të shumave të parave nga shtetasit. Megjithatë, ajo ka vlerësuar se kërkuesi ka pasur dijeni për veprimtarinë korruptive të disa prej të pandehurve të tjerë, por nuk e ka kallëzuar atë pranë organeve kompetente. Për sa i përket shtesës së ankimit, gjykata e apelit ka vendosur mospranimin, si të paraqitur jashtë afatit 15-ditor të parashikuar nga neni 415, pika 1, i KPP-së. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1833, datë 02.12.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

6. Në datën 02.06.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

7. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

8.1. *E drejta për proces të rregullt* në drejtim të:

8.1.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 41/2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar" (*ligji nr. 41/2021*), i cili ka ndryshuar nenin 75/a të KPP-së, gjykatat e posaçme nuk kanë pasur më kompetencë lëndore për gjykimin e punonjësve të thjeshtë të Policisë së Shtetit për veprën penale për të cilën ai ishte akuzuar. Çështja është regjistruar në datën 25.10.2022, ndërkohë që dispozita kalimtare e nenit 38, pika 3, të atij ligji ruan kompetencën vetëm çështjet e regjistruara përpara datës 01.06.2021. Po kështu, GJKKO-ja e Apelit ka shkelur nenin 375, pika 1, të KPP-së, duke ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale në një vepër që nuk përfshihet në kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme. Në momentin që GJKKO-ja e Apelit ka konstatuar se nuk ekzistonin prova për veprën penale të korrupsionit pasiv, duhej ta kishte kthyer çështjen për gjykim në gjykatën kompetente të juridiksionit të përgjithshëm.

8.1.2. *Parimit të zbatimit të ligjit penal më të favorshëm,* pasi kalimi i çështjes për gjykim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm do të përbënte një zgjidhje me të favorshme për pozitën e tij, duke qenë se ato gjykata ofrojnë garanci më të larta të paanshmërisë institucionale dhe janë më pak të ekspozuara ndaj trysnisë politike dhe mediatike.

8.1.3. *Pavlefshmërisë dhe papërdoshmërisë së provave të lidhur me të drejtën për respektimin e jetës private*, pasi vëzhgimi sekret nëpërmjet kamerave të fshehta është ekzekutuar në kabinat operative të pikës së kalimit kufitar, të cilat përbëjnë ambiente jo publike, me akses të kufizuar dhe me mbrojtje të veçantë ligjore. Në këto ambiente përpunohen informacione të klasifikuara dhe të dhëna personale, përfshirë të dhëna sensitive e biometrike. Për këtë arsye, kryerja e vëzhgimit sekret kërkonte autorizimin paraprak gjyqësor, në përputhje me nenin 224 të KPP-së, i cili nuk mund të zëvendësohej me një urdhër administrativ të prokurorit. Për më tepër, në kohën e instalimit të mjeteve të vëzhgimit sekret, në shkurt të vitit 2022, si persona nën hetim rezultonin të regjistruar vetëm dy shtetas, ndërsa shumica e personave që kishin qenë objekt i dyshimeve fillestare ishin larguar nga shërbimi. Kërkuesi ka qenë i ri në detyrë dhe nuk kishte asnjë lidhje me dyshimet mbi të

cilat ishte regjistruar procedimi penal. Për rrjedhojë, i gjithë procesi i vëzhgimit sekret ishte i paligjshëm *ab initio* dhe provat e përftuara janë të papërdorshme, në kuptim të nenit 151, pika 3, të KPP-së. Po ashtu, këto materiale nuk plotësojnë as kriteret minimale procedurale për t'u konsideruar si indicie.

8.1.4. *Së drejtës së mbrojtjes* dhe *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi GJKKO-ja e Apelit ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale pa e njoftuar paraprakisht kërkuesin dhe pa i dhënë mbrojtjes kohën e nevojshme për të përshtatur strategjinë e saj. Përballë akuzës fillestare, mbrojtja ishte përqendruar në kundërshtimin e elementeve të korrupsionit pasiv, veçanërisht në mungesën e veprimeve të kërkimit ose të pranimit të përfitimeve të parregullta. Ndërkohë, për veprën penale të moskallëzimit të krimit, për të cilën është dënuar në apel, kërkuesit nuk iu dha mundësia të paraqesë mbrojtjen e tij për mungesën e dijenisë mbi veprimtarinë kriminale të personave të tretë.

8.1.5. *Parimit të paanshmërisë,* pasi procedimi penal është zhvilluar nën një klimë të rëndë presioni politik dhe mediatik. Në datën 08.04.2022, përpara se çështja të shqyrtohej nga autoritetet gjyqësore, përfaqësues të lartë të pushtetit ekzekutiv (Kryeministri, ministri i Brendshëm dhe drejtori i përgjithshëm i Policisë) e deklaruan publikisht kërkuesin si të korruptuar, ndërsa media e portretizoi SPAK-un si strukturën që do të shpëtojë vendin nga gangrena e korrupsionit. Ky presion ka krijuar një zinxhir kauzal jashtëgjyqësor, ku gjykata e apelit, me qëllim edhe justifikimin e masës së paraburgimit të vuajtur nga kërkuesi, ka zgjedhur një rrugë kompromisi antiligjore, duke ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale.

8.1.6. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi kërkuesi është deklaruar fajtor për veprën penale të moskallëzimit të krimit, pa u provuar ekzistenca e krimit që pretendohet se nuk e ka kallëzuar dhe dijenia e tij për këtë krim. Episodi i datës 01.03.2022, mbi të cilin është mbështetur deklarimi i fajësisë së tij, nuk rezulton të jetë provuar si veprimtari kriminale, ndërkohë që të pandehurit e tjerë janë deklaruar fajtorë për episode të datave të ndryshme. Në këto kushte, GJKKO-ja e Apelit ka përmbysur barrën e provës, duke e ngarkuar kërkuesin të provonte mungesën e dijenisë për një krim, ekzistenca e të cilit nuk ishte provuar nga organi i akuzës. Ky parim është cenuar edhe për shkak të fillimit të ekzekutimit të dënimit alternativ përpara

marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor, pasi ekzekutimi ka filluar më 07.03.2023, ndërkohë që vendimi i GJKKO-së së Apelit, që ka përcaktuar përfundimisht përgjegjësinë e tij penale për veprën e moskallëzimit të krimit, është shpallur më 22.11.2023. Për rrjedhojë, për një periudhë disamujore, kërkuesi është trajtuar *de facto* si fajtor dhe u është nënshtruar detyrimeve që burojnë nga dënimi alternativ, përpara se të ekzistonte një vendim gjyqësor i formës së prerë për veprën penale për të cilën është dënuar përfundimisht.

8.1.7. *Mungesës së një mjeti efektiv juridik* të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve për mungesën e kompetencës lëndore të gjykatave të posaçme. Vendimi i saj përmban qëndrime kontradiktore, pasi në paragrafin 35 është shprehur për kufijtë e kompetencës së saj në rivlerësimin e fakteve, ndërsa në paragrafin 37 ka trajtuar çështjen e kompetencës lëndore. Meqenëse kjo e fundit është çështje ligjore, Gjykata e Lartë duhej të kishte dhënë përgjigje të arsyetuar për të. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka injoruar tërësisht dhe pa argumentim mendimin e gjyqtarit në pakicë të GJKKO-së së Apelit lidhur me moskompetencën lëndore të gjykatave të posaçme.

8.2. *Parimi i proporcionalitetit, së drejtës për liri dhe siguri personale dhe prezumimit të pafajësisë,* pasi ekziston një mospërputhje arbitrare dhe joproporcionale midis ashpërsisë së masës së sigurimit të vuajtur, pafajësisë për akuzën fillestare dhe dënimit të sajuar nga gjykata e apelit. Fakti i shpalljes i pafajshëm në apel për akuzën për të cilën ishte dënuar në shkallë të parë dëshmon se mbajtja në paraburgim e kërkuesit ka qenë e pajustifikuar. Nga ana tjetër, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit", për të cilën parashikohet një marzh i ulët dënimi, nuk plotësoheshin kriteret e neneve 228, 229 dhe 230 të KPP-së për caktimin dhe zbatimin e masës së sigurimit "Arresti në burg". Mbajtja në burg për një vepër penale që është rrëzuar, për t'u dënuar më pas për një vepër më të lehtë përbën një dënim të parakohshëm represiv. Për më tepër, kohëzgjatja e paraburgimit prej 10 muajsh e 21 ditësh dhe dënimi me 10 muaj burgim i caktuar nga GJKKO-ja e Apelit nuk është një koincidencë ligjore, por një aritmetikë artificiale institucionale, e bërë me qëllim mbulimin e gabimit të organit të akuzës,

justifikimin e privimit të mëparshëm të lirisë dhe shmangien e përgjegjësisë së shtetit për dëmshpërblim për burgim të paligjshëm.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

9. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private ose publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kriteret paraprake të legjitimimit janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi qoftë edhe i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes mund të vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete. Për rrjedhojë, verifikimi i mospërmbushjes edhe vetëm të një kriteri është i mjaftueshëm për të sjellë si pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Në rastin konkret, Kolegji çmon të ndalet në shqyrtimin e plotësimit të kritereve të *shterimit të mjeteve juridike efektive* dhe të legjitimimit *ratione materiae* të kërkuesit.

11. Kriteri i *shterimit të mjeteve juridike efektive,* që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës, parashikon se individi mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i

ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 31, datë 18.04.2024; nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, për qëllime të vlerësimit të plotësimit të këtij kriteri, është e rëndësishme të verifikohen pretendimet e parashtruara nga kërkuesi në ankimin kushtetues individual, duke i krahasuar ato me shkaqet e ngritura në rekursin e tij, si dhe me çështjet juridike të shqyrtuara nga Gjykata e Lartë mbi bazën e rekurseve të të gjykuarve të tjerë, referuar akteve të paraqitura bashkëlidhur ankimit kushtetues. Nga ky verifikim Kolegji konstaton se kërkuesi nuk i ka ngritur më parë, as shprehimisht dhe as në substancë, pretendimet që lidhen me: *i) cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* për shkak të mungesës së kompetencës lëndore të gjykatave të posaçme pas ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata e apelit; *ii) cenimin e parimit të zbatimit të ligjit penal më të favorshëm*, të lidhur me pretendimin se çështja duhej të gjykohej nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm; *iii) paligjshmërinë e vëzhgimit sekret dhe papërdorshmërinë e provave* të përfituara përmes tij, për shkak të kryerjes së këtij veprimi hetimor ndaj kërkuesit në mungesë të dyshimeve fillestare për përfshirjen e tij në veprimtarinë kriminale; *iv*) *cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit,* për shkak të ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata e apelit pa njoftim paraprak dhe pa i dhënë mbrojtjes mundësinë për t'u përgatitur ndaj akuzës së rikualifikuar; *v) cenimin e paanshmërisë,* për shkak të presionit politik dhe mediatik gjatë procedimit penal; *vi) cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë,* për shkak të fillimit të ekzekutimit të dënimit alternativ përpara marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor; *vii) cenimin e parimit të proporcionalitetit, të së drejtës për liri dhe siguri personale dhe të prezumimit të pafajësisë*, për shkak të kohëzgjatjes së paraburgimit në raport me veprën penale për të cilën është dënuar përfundimisht dhe me masën e dënimit të caktuar nga gjykata e apelit. Kolegji vëren se këto pretendime, në përmbajtjen dhe me argumentet konkrete me të cilat janë parashtruar në ankimin kushtetues individual, nuk janë ngritur ose shqyrtuar më parë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të paktën në substancë. Për rrjedhojë, në lidhje me to, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

13. Ndërkohë, për sa u përket pretendimeve për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* për shkak të mungesës së kompetencës lëndore të gjykatave të posaçme për shqyrtimin e procedimit penal, si dhe pretendimeve për *paligjshmërinë e vëzhgimit*

sekret dhe papërdorshmërinë e provave, për shkak të natyrës së ambienteve ku është kryer ky veprim hetimor dhe mungesës së autorizimit gjyqësor, Kolegji vëren se, ndonëse ato nuk rezultojnë të jenë ngritur në rekursin e vet kërkuesit, çështjet juridike përkatëse janë parashtruar nga të gjykuar të tjerë në të njëjtin proces penal dhe janë shqyrtuar në substancë nga Gjykata e Lartë *(shih vendimin e Gjykatës së Lartë, paragrafët 37-38).* Në këtë drejtim, Kolegji mban parasysh se kërkuesi, duke iu referuar nenit 416, pika 1, të KPP-së, ka pretenduar se shkaqet e ankimit që nuk bazohen në motive personale i shtrijnë efektet edhe ndaj të bashkëpandehurve të tjerë. Po kështu, sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), kriteri i shterimit të mjeteve juridike duhet të zbatohet me fleksibilitet dhe pa formalizëm të tepruar, duke mbajtur parasysh rrethanat e çështjes. Në këtë kuptim, GJEDNJ-ja ka pranuar se, në rrethana të caktuara, kur pretendimet e ngritura nga të bashkëpandehurit ose bashkëndërgjyqësit lidhen me shkelje që i prekin ata në mënyrë të përbashkët dhe këto pretendime janë sjellë mjaftueshëm në vëmendjen e autoriteteve kombëtare, qëllimi i kriterit të shterimit mund të konsiderohet i përmbushur edhe në mungesë të parashtrimit individual të të njëjtave pretendimeve. Në këtë vlerësim GJEDNJ-ja ka mbajtur parasysh edhe nëse përsëritja e të njëjtave kundërshtime nga kërkuesit do të kishte ofruar perspektivë më të madhe suksesi, duke vlerësuar nëse autoriteteve kombëtare u ishte dhënë mundësia reale për të shqyrtuar dhe korrigjuar shkeljet e pretenduara (*shih Asadbeyli dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit, 2012, §§ 116-120; Huseyn dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit, 2011, §§ 135-137*).

14. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë ka shqyrtuar kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme në raport me datën e regjistrimit të procedimit penal, në vitin 2020, dhe zbatimin e dispozitave kalimtare të ligjit nr. 41/2021, si dhe ligjshmërinë e përgjimeve në raport me natyrën e ambienteve ku ato janë kryer dhe autoritetin që i ka autorizuar. Këto çështje juridike, për shkak të natyrës së tyre, kanë qenë të përbashkëta për kërkuesin dhe të gjykuarit e tjerë dhe janë shqyrtuar dhe zgjidhur nga Gjykata e Lartë mbi bazën e pretendimeve të këtyre të fundit. Në këto rrethana, duke mbajtur parasysh se gjykatave të juridiksionit të zakonshëm u është dhënë mundësia për të shqyrtuar dhe korrigjuar shkeljet e pretenduara, si dhe se paraqitja individuale nga kërkuesi e të njëjtave shkaqe, pa argumente të tjera të dallueshme, nuk do të kishte ofruar perspektivë më të madhe suksesi, Kolegji vlerëson se për pretendimet e kërkuesit që përkojnë në substancë me këto çështje, kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive konsiderohet

i përmbushur. Për rrjedhojë, ato do të analizohen në vijim në drejtim të legjitimit *ratione materiae* të kërkuesit.

15. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit për cenimin e së drejtës për një mjet juridik efektiv të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se ai ka të bëjë me mënyrën sesi kjo gjykatë ka ushtruar kontrollin e saj dhe ka arsyetuar vendimin e mospranimit të rekursit të tij. Për këtë arsye, për sa ky pretendim lidhet me arsyetimin e vet vendimit të Gjykatës së Lartë, për të cilin kërkuesi nuk ka mjete të tjera të zakonshme ankimi, kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive konsiderohet i përmbushur. Megjithatë, Kolegji çmon se ky pretendim do të duhet të vlerësohet në raport me natyrën dhe përmbajtjen e shkaqeve të ngritura në rekursin e kërkuesit, si dhe me detyrimin e Gjykatës së Lartë për të shqyrtuar pretendimet që përfshihen në juridiksionin e saj.

16. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae* të kërkuesit, i cili ka të bëjë me natyrën kushtetuese të pretendimeve, Kolegji do të vlerësojë nëse pretendimet për të cilat është përmbushur kriteri i shterimit të mjeteve efektive ngrenë çështje të natyrës kushtetuese dhe nëse ato janë argumentuar në nivelin e kërkuar për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, për shkak të mungesë së kompetencës lëndore të gjykatave të posaçme, si dhe *paligjshmërinë e vëzhgimit sekret dhe papërdorshmërinë e provave* të përftuara prej tij. Po kështu, ai ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, për shkak se është deklaruar fajtor për veprën penale të moskallëzimit të krimit, pa u provuar, sipas tij, ekzistenca e krimit që pretendohet se kishte detyrimin të kallëzonte dhe dijenia e tij për këtë krim. Sipas kërkuesit, episodi i datës 01.03.2022, mbi të cilin është mbështetur deklarimi i fajësisë së tij, nuk rezulton të jetë provuar si veprimtari kriminale, ndërkohë që të pandehurit e tjerë janë deklaruar fajtorë për episode që u përkasin datave të ndryshme. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se GJKKO-ja e Apelit ka përmbysur barrën e provës, duke e ngarkuar të provonte mungesën e dijenisë për një krim, ekzistenca e të cilit nuk ishte provuar nga organi i akuzës. Kolegji vlerëson se këto pretendime, së bashku me kundërshtimet për arsyetimin e vendimeve gjyqësore, duhet të analizohen në drejtim të respektimit të garancive kushtetuese të procesit të rregullt ligjor.

17. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se një

nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një *"gjykatë e caktuar me ligj"*. Ky element, në sensin material, karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre, sipas një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 62, datë 04.11.2016; nr. 47, datë 11.11.2013; nr. 11, datë 23.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 36, datë 19.03.2026; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të paraqitura nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur, dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 26, datë 29.04.2025; nr. 12, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Sipas nenit 32, pika 2, të Kushtetutës, askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal dhe se sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimi i saj nga trupi gjykues cenojnë rregullshmërinë e procesit. Në këtë drejtim, Gjykata ka pohuar se asnjë gjykatë nuk mund të mbështetet në prova të marra me metoda të pandershme dhe të kundërligjshme, pa cenuar dhënien e drejtësisë (*shih vendimet nr. 55, datë 10.10.2025; nr. 67, datë 10.11.2017; nr. 7, datë 27.04.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka bërë dallim midis mënyrës së marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre në procesin gjyqësor. Ndërsa vlerësimi, dobia dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete janë, si rregull, detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit kushtetues, pasi ky aspekt ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Për sa i përket standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata ka theksuar se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe t'u japë mundësinë ta kundërshtojnë atë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes (*shih vendimet nr. 70, datë 15.10.2024; nr. 8, datë 20.02.2024; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, jurisprudenca kushtetuese ka pranuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit dhe arsyetimi të shprehë, në thelb, shkaqet e mospranimit gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit. Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë, në respektim të parimit të subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe atij të zakonshëm, duhet të mbajë një qëndrim të shprehur për to *(shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese).*

21. Mbi bazën e këtyre standardeve, Kolegji do të verifikojë nëse arsyetimi i vendimeve gjyqësore të kundërshtuara përmbush garancitë kushtetuese të sipërpërmendura, në veçanti nëse gjykatat kanë arsyetuar në lidhje me kompetencën lëndore, ligjshmërinë e marrjes së provave dhe përgjegjësinë penale të kërkuesit, në përputhje me garancitë e procesit të rregullt ligjor, pa marrë përsipër të rivlerësojë fuqinë provuese të provave ose të zëvendësojë përfundimet e gjykatave të

juridiksionit të zakonshëm me një vlerësim tjetër të tyre. Në këtë drejtim, Kolegji mban parasysh se çështja penale ndaj kërkuesit, me kërkesën e tij, është shqyrtuar sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar. Përmes zgjedhjes së kësaj procedure, kërkuesi ka pranuar që çështja të gjykohej në gjendjen në të cilën ndodheshin aktet e hetimit paraprak, sipas rregullave të posaçme të kësaj forme gjykimi. Kjo do të thotë se kërkuesi ka pranuar me vullnetin e tij vlefshmërinë e akteve të hetimit paraprak, pra se ai nuk ka pasur kundërshtime në lidhje me to. Megjithatë, Kolegji vlerëson se kjo zgjedhje nuk përjashton detyrimin e gjykatave për të respektuar garancitë kushtetuese të procesit penal, përfshirë prezumimin e pafajësisë dhe arsyetimin e vendimit gjyqësor.

22. Për sa i takon shqyrtimit të themelit të akuzës të ngritur nga Prokuroria e Posaçme, GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka deklaruar kërkuesin fajtor për veprën penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 259, paragrafi i parë, në lidhje me nenin 25 të KP-së. Sipas asaj gjykate, nga të dhënat e përfituara prej pamjeve audio dhe video të regjistruara, bisedave të transkriptuara, procesverbaleve të këqyrjes së pamjeve filmike, si dhe nga dinamika e sjelljes dhe e veprimeve të të pandehurve, rezultonte se kërkuesi dhe disa prej të pandehurve të tjerë kishin bashkëpunuar në veprimtarinë e marrjes së shumave të parave nga shtetasit gjatë ushtrimit të detyrës. Po sipas saj, megjithëse nuk evidentoheshin veprime të drejtpërdrejta të kërkuesit në kërkimin, marrjen ose pranimin e shumave të parave nga shtetasit, tërësia e veprimeve dhe komunikimeve të tij me të pandehurit e tjerë provonte dijeninë dhe bashkëpunimin e tij në këtë veprimtari korruptive. Në veçanti, gjykata i ka dhënë rëndësi pranisë dhe rolit të kërkuesit gjatë grumbullimit të shumave të parave, me qëllim shpërndarjen e tyre, duke vlerësuar se këto rrethana, të shqyrtuara në lidhje me njëra-tjetrën, provonin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm pjesëmarrjen e tij në veprimtarinë e kundërligjshme dhe, për rrjedhojë, përgjegjësinë penale për veprën e parashikuar nga neni 259, paragrafi i parë, në lidhje me nenin 25 të KP-së.

23. Në ndryshim nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se nuk provohej përtej çdo dyshimi të arsyeshëm pjesëmarrja e kërkuesit në kryerjen e veprës penale të korrupsionit pasiv, në bashkëpunim. Sipas asaj gjykate, ndonëse kërkuesi rezultonte i pranishëm në momentin kur kolegët e tij i kishin dorëzuar të pandehurit H.H. shuma parash që buronin nga veprimtaria korruptive, nuk provohej që ai të kishte kryer veprime konkrete të kërkimit, marrjes ose pranimit të këtyre shumave nga shtetasit që kalonin kufirin. Gjykata e apelit ka marrë në konsideratë edhe natyrën e detyrës së kërkuesit si përgjegjës grupi/turni, për shkak të së cilës ai

nuk kryente drejtpërdrejt përpunimin e shtetasve në sportele. Megjithatë, duke iu referuar pamjeve audio dhe video të datës 01.03.2022, bisedave të transkriptuara, si dhe dinamikës së sjelljes dhe të veprimeve të dokumentuara, ajo ka arritur në përfundimin se kërkuesi kishte dijeni për veprimtarinë korruptive të kryer nga të pandehurit H.H., R.L. dhe E.T., që konsistonte në marrjen e shumave të parave nga shtetasit gjatë ushtrimit të detyrës, por nuk e kishte kallëzuar atë. Në këtë drejtim, gjykata e apelit i ka dhënë rëndësi pranisë së kërkuesit në fazën e grumbullimit të shumave të parave, me qëllim shpërndarjen e tyre, si dhe bisedave që ai kishte zhvilluar me të pandehurin H.H. Për këto arsye, GJKKO-ja e Apelit ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale, duke e deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale "Moskallëzimi i krimit", të parashikuar nga neni 300, pika 1, i KP-së.

24. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë, në shqyrtimin paraprak të rekurseve të paraqitura nga të gjykuarit, përfshirë kërkuesin, ka vendosur mospranimin e tyre. Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata e Lartë ka theksuar se, si gjykatë e ligjit, juridiksioni i saj kufizohet në kontrollin e shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së dhe se pretendimet që lidhen me rivlerësimin e fakteve dhe të provave nuk përfshihen në kompetencën e saj. Njëkohësisht, ajo ka sqaruar se kontrolli i saj shtrihet mbi zbatimin e drejtë të ligjit material dhe procedural, si dhe mbi respektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në këtë kuadër, Gjykata e Lartë ka shqyrtuar pretendimet për kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme dhe ligjshmërinë e përgjimeve të ngritura nga të gjykuar të tjerë në të njëjtin proces penal, duke i vlerësuar ato të pabazuara *(shih vendimin e Gjykatës së Lartë, paragrafët 37-38)*. Po kështu, ajo ka vlerësuar se pretendimet që lidhen me provueshmërinë e akuzave, ekzistencën e elementeve të veprave penale dhe arsyetimin e vendimit gjyqësor nuk evidentonin shkaqe ligjore që të justifikonin cenimin e vendimit të kundërshtuar. Sipas Gjykatës së Lartë, kundërshtimet e të gjykuarve, përfshi edhe të kërkuesit, synonin, në thelb, një rivlerësim të ndryshëm të provave, ndërsa pretendimet thelbësore të ngritura në rekurse kishin marrë përgjigje të argumentuar në prova dhe ligj nga gjykatat e faktit. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se edhe në rekursin e kërkuesit nuk evidentohej asnjë prej shkaqeve ligjore të parashikuara nga neni 432 i KPP-së *(shih vendimin e Gjykatës së Lartë, paragrafët 35, 36, 40 dhe 41)*.

25. Duke iu kthyer pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, Kolegji vëren se çështja e kompetencës lëndore të gjykatave të posaçme është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka mbështetur përfundimin e gjykatave më të ulëta për

kompetencën e tyre. Në këtë drejtim, Gjykata e Lartë ka marrë në konsideratë faktin se procedimi penal në rastin konkret ishte regjistruar në vitin 2020, përpara datës 01.06.2021, duke vlerësuar se për përcaktimin e kompetencës lëndore gjenin zbatim dispozitat kalimtare të ligjit nr. 41/2021, konkretisht nenet 38 dhe 39 të tij. Në këtë kuptim, neni 38, pika 3, parashikon ruajtjen e kompetencës së prokurorisë dhe gjykatave të posaçme për çështjet që ishin në kompetencën e tyre sipas nenit 75/a të KPP-së, përpara ndryshimeve ligjore, dhe që ishin regjistruar përpara datës 01.06.2021, pavarësisht ndryshimit të kompetencës lëndore. Ndërsa neni 39, pika 2, përcakton datën 01.06.2021 si datën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve të nenit 75/a të KPP-së. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë e ka lidhur zbatimin e dispozitave kalimtare me datën e regjistrimit të procedimit penal, duke e dalluar këtë moment nga regjistrimi i mëvonshëm i çështjes për gjykim, të cilit i referohet kërkuesi. Po kështu, Gjykata e Lartë i është referuar nenit 75/a të KPP-së, në formulimin përpara ndryshimeve ligjore, si dhe rregullave për procedimet e lidhura, sipas nenit 80 të KPP-së. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka identifikuar bazën ligjore të kompetencës dhe ka parashtruar arsyet për të cilat çështja vijonte të ishte në juridiksionin e gjykatave të posaçme. Kolegji vëren se kundërshtimet e kërkuesit ndaj këtij përfundimi lidhen me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të dispozitave për kompetencën lëndore, ndërsa nga arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk rezulton një zbatim haptazi arbitrar i tyre ose një shmangie e dukshme nga rregullat ligjore të përcaktimit të gjykatës kompetente, që të cenonte garancinë kushtetuese të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se ky pretendim i kërkuesit, në kufijtë në të cilët është konsideruar i shteruar, është haptazi i pabazuar.

26. Për sa i përket pretendimit për paligjshmërinë e vëzhgimit sekret dhe papërdorshmërinë e provave të përftuara përmes tij, Kolegji vlerëson se ky pretendim, për nga përmbajtja e tij, lidhet me garancinë e nenit 32, pika 2, të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë ka shqyrtuar kundërshtimet lidhur me natyrën e ambienteve ku janë vendosur pajisjet e regjistrimit dhe autoritetin që ka autorizuar këtë veprim hetimor. Ajo ka mbështetur arsyetimin e GJKKO-së së Apelit, sipas të cilit kabinat e kontrollorëve në pikën e kalimit kufitar përbëjnë ambiente ku ofrohet shërbim publik dhe ushtrojnë detyrën punonjës të ndryshëm të Policisë së Shtetit, në varësi të turneve të shërbimit. Nisur nga kjo natyrë e ambienteve, gjykatat kanë vlerësuar se regjistrimi i fshehtë me video i nënshtrohej rregullimit të nenit 221, pika 2, të KPP-së dhe se autorizimi i prokurorit ishte në përputhje me nenin 222, pika 8, të këtij kodi. Kolegji

konstaton se gjykatat kanë shqyrtuar ligjshmërinë e marrjes së provave, duke vlerësuar nëse ambientet ku është kryer vëzhgimi sekret përfshiheshin në kategorinë e vendeve publike, për të cilat ligji procedural lejonte autorizimin e regjistrimit nga prokurori. Në këtë mënyrë, ato kanë identifikuar bazën ligjore të kryerjes së veprimit hetimor dhe kanë parashtruar arsyet për të cilat kanë konsideruar të ligjshëm autorizimin e tij dhe të përdorshme provat e përftuara. Duke i vlerësuar këto përfundime në dritën e garancisë së nenit 32, pika 2, të Kushtetutës, Kolegji çmon se interpretimi dhe zbatimi i dispozitave procedurale nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk rezulton të jetë haptazi arbitrar dhe as të evidentojë shkelje të dukshme të rregullave ligjore për marrjen e provave, që do të vinin në dyshim ligjshmërinë e të dhënave mbi të cilat është mbështetur deklarimi i fajësisë së kërkuesit. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi për paligjshmërinë e vëzhgimit sekret dhe papërdorshmërinë e provave të përftuara përmes tij, në kufijtë në të cilët është konsideruar i shteruar, është haptazi i pabazuar.

27. Për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, Kolegji vëren se thelbi i kundërshtimit të kërkuesit lidhet me mungesën e të provuarit të krimit që ai kishte detyrim ta kallëzonte dhe të dijenisë së tij për këtë krim. Në këtë drejtim, Kolegji mban parasysh se përgjegjësia penale për veprën e moskallëzimit të krimit, sipas nenit 300, pika 1, të KP-së, presupozon identifikimin e faktit penal që përbën objektin e detyrimit për kallëzim, dijeninë e të pandehurit për këtë fakt dhe mosveprimin e tij për ta kallëzuar atë. Provueshmëria e këtyre elementeve duhet të rezultojë nga arsyetimi i vendimit gjyqësor, në përputhje me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe standardin e provimit të fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

28. Në rastin konkret, Kolegji vëren se GJKKO-ja e Apelit ka identifikuar veprimtarinë korruptive të të pandehurve H.H., R.L. dhe E.T., që konsistonte në marrjen e shumave të parave nga shtetasit gjatë ushtrimit të detyrës në pikën e kalimit kufitar Morinë. Nga arsyetimi i asaj gjykate rezulton se ajo ka vlerësuar të provuar edhe episode të veprimtarisë korruptive të kryera në data të ndryshme, përfshirë datën 01.03.2022, për të cilat janë deklaruar fajtorë të pandehurit e sipërpërmendur. Ndërkohë, për sa i përket kërkuesit, gjykata e apelit ka vlerësuar se prania e tij në datën 01.03.2022, gjatë grumbullimit dhe dorëzimit të shumave të parave, e shqyrtuar në lidhje me komunikimet dhe veprimet e tij të dokumentuara, provonte dijeninë për veprimtarinë korruptive të kolegëve dhe moskallëzimin e saj. Në këtë kuptim, Kolegji vëren se data 01.03.2022 lidhet me rrethanat konkrete mbi të cilat gjykata ka mbështetur përfundimin për dijeninë e kërkuesit, pa qenë e nevojshme që të gjitha veprimet korruptive për të cilat ai kishte detyrimin e kallëzimit të ishin

kryer pikërisht në atë datë ose që kërkuesi të kishte qenë i pranishëm në momentin e kryerjes së tyre. Për rrjedhojë, nga arsyetimi i vendimit të GJKKO-së së Apelit rezulton se ajo ka identifikuar faktin penal që e ka konsideruar të pakallëzuar dhe ka parashtruar provat mbi të cilat ka mbështetur përfundimin për dijeninë e kërkuesit.

29. Mbi bazën e këtyre rrethanave, Kolegji vlerëson se GJKKO-ja e Apelit ka individualizuar përgjegjësinë penale të kërkuesit për veprën penale për të cilën e ka deklaruar fajtor, duke dalluar mungesën e të provuarit të pjesëmarrjes së tij në veprimtarinë korruptive nga dijenia për këtë veprimtari dhe moskallëzimi i saj. Në këtë drejtim, fakti që GJKKO-ja e Apelit nuk e ka konsideruar të provuar pjesëmarrjen e kërkuesit në një veprimtari korruptive nuk bie në vetvete në kundërshtim me përfundimin e saj për dijeninë e tij për këtë veprimtari dhe moskallëzimin e saj, përderisa këto përfundime mbështeten në vlerësimin e provave përkatëse. Për sa i përket pretendimit për përmbysjen e barrës së provës, Kolegji vëren se kërkuesi e ka mbështetur atë në argumentin se është deklaruar fajtor për moskallëzimin e një krimi, ekzistenca e të cilit, sipas tij, nuk ishte provuar nga organi i akuzës. Megjithatë, siç është evidentuar më sipër (*shih paragrafin 23 të vendimit*), gjykata e apelit e ka identifikuar veprimtarinë korruptive të kolegëve të kërkuesit, përfshirë edhe episodin e datës 01.03.2022, si dhe ka parashtruar provat dhe rrethanat mbi të cilat ka mbështetur përfundimin për dijeninë e tij lidhur me këtë veprimtari. Në këto rrethana, duke vlerësuar arsyetimin në tërësi të vendimit të GJKKO-së së Apelit dhe argumentet konkrete të parashtruara në ankimin kushtetues, Kolegji nuk konstaton që gjykata e apelit t'i ketë ngarkuar kërkuesit detyrimin për të provuar mungesën e dijenisë për krimin, duke e përjashtuar organin e akuzës nga barra e provimit të saj. Ndërkohë, kundërshtimet e kërkuesit ndaj përfundimeve të GJKKO-së së Apelit, për sa lidhen me mënyrën e vlerësimit të provave dhe fuqinë e tyre provuese, nuk mund të çojnë, si të tilla, në konstatimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë. Në këto kushte, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e këtij parimi është haptazi i pabazuar.

30. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Kolegji vëren se GJKKO-ja e Apelit ka parashtruar arsyet për të cilat ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale dhe ka përcaktuar përgjegjësinë e kërkuesit për moskallëzimin e krimit, duke identifikuar provat mbi të cilat është mbështetur dhe duke shpjeguar dallimin ndërmjet mungesës së të provuarit të pjesëmarrjes së tij në veprimtarinë korruptive, sipas akuzës fillestare, dhe përfundimit për dijeninë e tij për këtë veprimtari dhe moskallëzimin e saj. Nga ana tjetër,

Gjykata e Lartë ka paraqitur rrethanat e çështjes, ka përmbledhur vendimmarrjen e gjykatave të faktit dhe ka evidentuar shkaqet e rekurseve të paraqitura nga të gjykuarit, përfshirë kërkuesin. Ajo ka përcaktuar kufijtë e kontrollit të saj si gjykatë ligji dhe ka dhënë përgjigje të posaçme për pretendimet lidhur me kompetencën lëndore dhe ligjshmërinë e përgjimeve, të ngritura nga të gjykuar të tjerë në të njëjtin proces penal. Po kështu, ajo ka vlerësuar se pretendimet lidhur me provueshmërinë e akuzave, ekzistencën e elementeve të veprave penale dhe respektimin e standardeve procedurale nuk evidentonin shkaqe ligjore që të justifikonin cenimin e vendimit të kundërshtuar.

31. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit për ekzistencën e një kontradikte në arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se përcaktimi i kufijve të juridiksionit të saj në lidhje me vlerësimin e fakteve dhe provave, nga njëra anë, dhe shqyrtimi i çështjes së kompetencës lëndore, si çështje e zbatimit të ligjit, nga ana tjetër, nuk përbëjnë qëndrime kontradiktore. Për sa u përket pretendimeve të ngritura në rekursin e kërkuesit, në masën që ato lidhen me kundërshtimet objekt të ankimit kushtetues, arsyetimi i vendimit të mospranimit nga Gjykata e Lartë, i lexuar së bashku me paraqitjen e tyre dhe me arsyetimin e GJKKO-së së Apelit, i bën të identifikueshme arsyet e mospranimit. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për mosmarrjen në shqyrtim të mendimit të pakicës së gjyqtarit të gjykatës së apelit, Kolegji vëren se ky mendim nuk përbën arsyetimin mbi të cilin mbështetet vendimi i shumicës dhe, si i tillë, nuk është objekt më vete i kontrollit nga Gjykata e Lartë. Kontrolli i kësaj të fundit ushtrohet mbi vendimin gjyqësor të kundërshtuar, në raport me shkaqet e ngritura në rekurs dhe brenda kufijve të juridiksionit të saj. Për rrjedhojë, mungesa e një qëndrimi të veçantë të Gjykatës së Lartë në lidhje me mendimin e pakicës nuk përbën, në vetvete, cenim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se, brenda kufijve të pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues, nuk evidentohen mangësi të tilla në arsyetimin e vendimeve gjyqësore që të vënë në dyshim respektimin e garancisë kushtetuese të procesit të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

32. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.